



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:262812

Datë: 26.05.2022

Numri i dokumentit: 03058159

A.nr.468/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësve U.i P. me seli në P.si dhe R. V.me adresë në Rrugën e Sh., kundër të paditurit Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit Nr.25/2017 të datës 07.02.2017 si dhe vendimit të shkallës së parë nën shenjën 01nr.56-48/2016-B i datës 12.12.2016, me kërkesë për kthimin e mjeteve monetare, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik, me datë 12.05.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve U.i P. me seli në P.si dhe R. V.me adresë në “R. e Sh.”.

II. ANULOHET vendimi i shkallës së dytë Nr.25/2017 të datës 07.02.2017 si dhe vendimi i shkallës së parë nën shenjën 01nr.56-48/2016-B i datës 12.12.2016.

III. OBLIGOHET i padituri që paditësit të parë U. të P. t’ia kthej mjetet monetare në lartësi prej 5,300.00€ [pesë mijë e treqind euro e zero cent] në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar si dhe t’ia kthej paditësit të dytë R. V.mjetet monetare në lartësi prej 2,000.00 [dy mijë euro], e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

IV. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së me praninë e palëve paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësit me padinë e datës 13.03.2017 kanë kërkuar anulimin e vendimeve të kontestuara të Inspektoratit të Punës, përkatësisht të vendimit Nr.25/2017 të datës 07.02.2017 si dhe vendimi i shkallës së parë nën shenjën 01nr.56-48/2016-B i datës 12.12.2016. Anulimi i këtyre vendimeve është kërkuar mbi bazën e asaj që nuk janë aplikuar fare apo nuk janë zbatuar drejtë dispozitat e ligjit dhe për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike apo nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Në lidhje me pretendimet e Inspektoratit të Punës se konkurset e shpallura publike nuk janë proceduar në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.14/2011, paditësit pohojnë se të gjitha konkurset e shpallura për zgjedhjen e personelit akademik janë bërë duke i ndërmarrë të gjitha masat për respektimin e procedurave të konkurseve duke zgjedhur stafin i cili ka plotësuar kushtet dhe mos përzgjedhur kandidatët të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet, ndonëse numri i vendeve të lira mund të ketë qenë më i madh dhe se vendimi për secilin kandidat është marrë nga komisionet përkatëse recensuese të krijuara në bazë të Statutit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”. Gjithashtu në disa raste janë angazhuar një numër i mësimdhënësve jo të rregullt, pra semestral dhe në asnjë rast nuk është provuar dhe as ska pasur cënim të nenit 8 të Ligjit të Punës dhe as të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011.

Paditësit poashtu pohojnë se Inspektorati i Punës ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin kur ka vlerësuar se Rektori i Universitetit të Prizrenit bën përzgjedhjen e stafit, për fakti që përzgjedhja e stafit bëhet nga komisionet respektive të njëjësive përkatëse akademike.

Poashtu pohojnë se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ka ndodhur edhe në rastin e marrjes së pushimit të lehonisë nga znj. Dh. H., për faktin që në kërkesën për pushimin e lehonisë ishte përcaktuar edhe periudha e pushimit të lehonisë dhe nuk ka qenë i nevojshëm nxjerrja e një vendimi të ri pasi që neni 67, paragrafi 6 nuk e kërkon një gjë të tillë.

Paditësit poashtu pohojnë se Inspektorati i Punës nuk ka dhënë arsye se si është shkelur neni 11, paragrafi 3 i Ligjit për Siguri dhe Shëndetin në Punë sa i përket trajnimit të stafit për mbrojtje dhe siguri në punë, ku ky konstatim është mjaft konfuz dhe me këtë rast Inspektorati ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjithashtu nuk qëndrojnë pretendimet e Inspektoratit të Punës sa i përket shkeljes së nenit 95 të Ligjit të Punës për faktin që kjo dispozitë i referohet dispozitave kalimtare dhe e cila nënkupton që brenda 6 muajve të hyrjes në fuqi, Institucionet obligohen që të nxjerrin aktet e tyre të brendshme e që në rastin e Universitetit të Prizrenit, i njëjti ka funksionuar me statut të përkohshëm deri me 30 Maj 2013 kur është miratuar Statuti i Universitetit të Prizrenit i cili tani është në fuqi kurse Ligji i Punës ka hyrë në fuqi në vitin 2010.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e paditësit të parë deklaroi: *“mbetet në tërësi pranë padisë ushtruar kundër MPMS-së- Inspektorati i Punës, të anulohet vendimi i Inspektoratit të Punës numër 56-48/2016 B, për arsye se vendimi përmban aplikim të gabuar të dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punës si dhe arsyeve, fakteve , provave të dorëzuara në afat ligjor së bashku me padinë. Inspektorati i Punës ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe si rrjedhojë ka shqiptuar masë ndëshkimore për institucionin në total vlerë 5,300 €, si dhe për rektorin e Universitetit në atë kohë Prof. R. V.shumën prej 2000€”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Duke u bazuar në thëniet e cekura më lart U. U. H., i propozon gjykatës të merr aktgjykim që të anulohet në tërësi vendimin për shqiptim të masës ndëshkimore për Institucionin dhe për paditësin e dytë si person fizik. Detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve në shumë prej 5.300 € për institucionin dhe 2.000 €, për paditësin e dytë”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësi i dytë deklaroi: *“Mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar, Inspektorati i Punës me vendimin e lëshuar nuk ka konstatuar drejt gjendjen faktike dhe si rezultat i këtij konstatimi jo të drejtë mua personalisht më ka shqiptuar gjobë në shumë prej 2.000 €, të cilën shumë e kam përmblyer në procedurë përmblyesore dhe të njëjtën e kam paguar. Në padi kemi përshkruar detajisht gjendjen e drejtë faktike të cilave u kemi bashkangjitur edhe provat të cilat dëshmojnë e Inspektorati i Punës ka nxjerr vendim jo të drejtë duke shkelur Ligjin Material, duhet theksoj se ky Inspektim është bërë enkas për të më dënuar sepse nuk ka pasur asnjë ankesë lidhur me gjetjet e inspektoratit të punës. Gjykatës në cilësi të provës ia dorëzoi edhe dëshminë pagesës së kësaj mase ndëshkimore nga ana e të paditurit . Sa i përket njëres nga gjetjet e inspektoratit që ka të bëjë me çështjen e pushimit të lehonisë për njërin nga asistentët. Ju njoftoj se personeli me automatizëm e lëshon vendimin për vazhdim të pushimit të lehonisë ( Pjesën e dytë), paragrafi 4 neni 49 Ligji i Punës , por që vet pala duhet të paraqitet në MPMS –së për të dorëzuar vendimin për pagesë të pjesës së dytë të pushimit. Me dt. 30.08.2016, punëtorja në fjalë ka bërë kërkesë me shkrim për kthim nga pushimi i lehonisë bashkangjitur gjeni kërkesën e dt. 30.08.2016. Kërkesa është bërë me dt. 30.08.2016 sepse administrata ka qenë në pushim vjetor nga data 01.08.2016 deri me dt. 25.08.2016. Për vërtetimin e të dhënave të lartshënuara përveç dokumentacionit të bashkangjitur gjeni edhe numrin kontaktues të profesoreshës në fjalë e cila ka kërkuar 4 muaj pushim të lehonisë, për këtë arsye ka bërë kërkesë për ndërprerje të pushimit me arsye se e njëjta me vetë dëshirë ka kërkuar të kthehet në punë. Në raporte me gjetjet sa i përket konkurseve janë pranuar vetëm ata të fushës kompetente p.sh. konkursi numër 01-21 i dt. 21.01.2016, kanë qenë të lira 25 pozita por janë pranuar 20 dhe kjo nuk konsiderohet shkelje , përkundrazi pranimi i stafit në kundërshtim e dispozitat e Ligjit për Arsim të Lartë dhe Statutit të Universitetit, të cilët nuk i plotësojnë kushtet sipas konkursit përbën shkelje ligjore.*

*Konstatimi i Inspektoratit të Punës për mos ndërprerjen e marrëdhënies së punës për profesorët mbi 65 vjeç , me arsyetimin se është shkelur dispozita e nenit 67 par. 1.4 nuk qëndron. Universiteti janë raste specifike për faktin se ato bazë ligjore kanë Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutet me të cilat rregullohet funksionimi dhe marrëdhënia e punës , këtë e plotëson edhe me tepër vendimi i Ministrit të MASHT-it ,i cili thotë se për raste të veçanta mund të angazhohet stafi që ka plotësuar moshën 65 vjeç e që nuk e kalon moshën 70 vjeçare . Gjithashtu kemi të bashkangjitur edhe alterimin e Z. V. H. i cili është punëtor i rregullt i Universitetit dhe i njëjti është i certifikuar për përdorim të aparateve për shuarje të zjarrit dhe dhënien E ndihmës së parë – evakuim dhe shpëtim sipas ligjit numër 04/L-161 . Kemi një punëtorë të rregullt dhe një me marrëveshje për shërbime të veçanta të certifikuar për përdorim të aparateve , fikjen e zjarrit dhe dhënien ndihmës së parë – sigurim dhe shëndetin në punë”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Mbesim pranë padisë së parashtruar dhe deklarimeve të bëra , kërkoj nga gjykata që pas shqyrtimit të padisë kërkesëpadisë dhe administrimit të provave të nxjerr aktgjykim ashtu që ta aprovoi padinë si të bazuar, të anulohet vendimin e Inspektoratit të Punës , të detyroj Inspektoratin e Punës t'ia paguaj paditësit shumën prej 2000 € në emër të kthimit të mjeteve pas anulimit të vendimit për shqiptimin e gjobës , meqenëse i paditësit ka përmblyer gjobën kërkoj nga gjykata të vendos në mënyrë meritore”.*

E paditura me përgjigjen në padi të datës 04.02.2019 e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar. Shton se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar dhe mbetet në fuqi vendimet e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: konkursi numër 355 i dt. 11.09.2015, njoftimi i datës 30.01.2015, buletini numër 10/b i dt. 22.03.2016, raporti i komisionit recensues dt. 22.03.2016, buletini i datës 14.03.2016, buletini i dt. 23.02.2016, raporti i Komisionit Recensues dt. 23.02.2016, buletini i dt. 18.02.2016, raporti i komisionit recensues dt. 18.02.2016, raporti i komisionit recensues dt. 15.02.2016, buletini i dt. 16.02.2016, buletini i dt. 10.02.2016, vendimi i dt. 10.03.2016, vendimet e dt. 29.03.2016,30.03.2016, 01.04.2016, konkursi i dt. 21.01.2016, vendimi i dt. 12.10.2016, vërtetimi i dt. 07.03.2012, kontrata për shërbime të veçanta i dt. 13.10.2016, aktemrimi i dt. 01.07.2016, vërtetimi i dt. 11.05.1984, vendimi i dt. 31.10.2016, marrëveshja e bashkëpunimit e dt. 07.09.2016, vendimi i dt. 30.05.2013, Statuti i Universitetit “U. H.”, 30.05.2013, vendimet e dt. 16.12.2015, vendimi i dt. 23.11.2015, vendimi i dt. 27.10.2015, 26.10.2015, buletini i dt. 02.10.2015, raporti i Komisionit Recensues 22.09.2015, raporti i dt. 02.10.2015, 14.09.2015, 15.09.2015, referatet e kandidatëve në Buletinin e dt. 14.09.2015, buletini i dt. 10.09.2015, një shkrim nga gazeta Telegrafi.com i dt.12.03.2017, vendimi i dt. 29.07.2015, konkursi i dt.31.07.2015, vendimi i Organit të Shkalles së Parë numër 01 nr.56-48/2016–B dt.12.12.2016, ankesa e dt. 22.12.2016, vendimi i kontestuar me numër IP 25/2017 dt. 07.02.2017, kërkesa për kthim nga pushimi i Lehonisë dt. 30.08.2016, kontrata e Punës e dt.25.05.2015, aktvendimi mbi shfrytëzimin pushimit e lehonisë 09.02.2016, kërkesa për pushim të lehonisë dt. 29.01.2016, kontratat e punës dt. 31.03.2015, 19.03.2015, raporti zyrtar i inspektimit i dt. 20.07.2016, ankesa e dt. 22.12.2016 si dhe raporti Zyrtar i ri inspektimit i dt. 28.10.2016.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësve lidhur me kërkesëpadinë e tyre dhe gjeti se padia e paditësve është e bazuar.

Gjykata konstatoi se e paditura me vendimin e kontestuar, nuk ka trajtuar qartë pretendimet ankimore të paditësve, ashtu që arsyetimi i vendimit nuk korospondon me kërkesat specifike të palës paditëse dhe nuk përmban dëshmi mbi bazën e së cilave është refuzuar ankesa e paditësve.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative.

Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajnë përveç tjerash, edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e

paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj.

Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit Ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsytet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj.

Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Gjykata gjeti se i padituri me vendimin e kontestuar nuk ka arritur të dëshmojë as në vendimin e kundërshtuar dhe as në përgjigjen në padi se si nuk qëndrojnë pretendimet e paditësve se me rastin e shqiptimit të gjobës në shumën prej 5300€ për paditësin e parë dhe 2000€ për paditësin e dytë, është bërë vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike me ç'rast ka ardhur edhe te zbatimi i gabuar i së drejtës materiale.

Gjykata vëren se i padituri në fillimpjesën e arsyetimit të vendimit të kundërshtuar, përshkruan procedurën e fillimit të inspektimit nga ana e Inspektorëve të Punës si organ i shkallës së parë. Në lidhje me këtë, gjykata vëren se kjo formë e arsyetimit as nuk kërkohet nga çfarëdo dispozite ligjore dhe as nuk është e nevojshme apo e domosdoshme të përshkruhen veprimet e organit administrativ të shkallës së parë.

Gjykata fillimisht ju referua arsyetimit të të paditurës në vendimin e kontestuar në pjesën ku trajtohet konkursi për mësimdhënës dhe asistentë i datës 24.12.2014 dhe ku e paditura në mënyrë të paqartë dhe konfuze pohon kështu: *“Në konkursin e lartëcekur janë kërkuar 12 (dymbëdhjetë) mësimdhënës dhe 3 (tre) asistentë, ndërsa punëdhënësi ka pranuar vetëm dy mësimdhënës. Për inspektorët e punës, punëdhënësi nuk ka arsyetuar mosplotësimin e 13 (trembëdhjetë) vendeve tjera të punës”*. Në gjykimin e kësaj Gjykate, është e qartë se një kërkesë apo pritshmëri e tillë nga ana e të paditurit, në mënyrë absolute nuk gëzon asnjë mbështetje ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të kërkohet llogari nga punëdhënësi-në këtë rast nga paditësit që të japin arsyetim pse nuk janë plotësuar vendet e lira të punës. Gjykata konstatoi se mbi asnjë bazë ligjore nuk mund të kërkohet domosdoshmërisht plotësimi i vendeve të punës, për faktin që vendet e punës mbulohen vetëm atëherë kur kandidatët plotësojnë kushtet e parapara në konkurs, si në aspektin e përgatitjes akademike ashtu edhe në aspektin e përvojës së punës apo specifikave tjera që mund të jenë të veçanta për çdo konkurs. I njëjti konstatim i Gjykatës vlen edhe për rastet tjera mbi bazën e të cilave, i padituri ka pretenduar të mbështes vendimin e tij të paligjshëm për shqiptimin e gjobës ndaj paditësve.

Gjykata refuzoi pretendimet e të paditurit sa i përket lidhjes së kontratës me punonjësit mbi 65 vite dhe në këtë drejtim, rikonfirmoi faktin se njëjtë sikurse edhe Universitetit tjera publike, ashtu edhe paditësi, me faktin e angazhimit të profesorëve deri në moshën 70 vjeçare, nuk ka rënë ndesh me dispozitat e Ligjit të Punës, e aq më pak për faktin që një angazhim i tillë është në përputhje të plotë me nenin 177.5 të Statutit të U. të P. “U.H..”. Në këtë kontekst, është i paqëndrueshëm pohimi i të paditurit të dhënë në arsyetimin e vendimit të kontestuar se: “*nuk ka parashtruar kërkesë të arsyetuar mirë nga njësia akademike ku punëdhënësi mund të angazhoj staf akademik*”. Në këtë kuptim, gjykata konstatoi se ky konstatim i të paditurit është i pasaktë për faktin që vlerësimi nëse kërkesa është arsetuar mirë apo jo, nuk bëhet dhe nuk duhet të bëhet nga i padituri, por pikërisht nga organet përgjegjëse të paditësit, për faktin që janë pikërisht ata të cilët më së miri i dinë nevojat e Universitetit dhe njësive akademike për sistemin e kësaj kategorie të mësimdhënësve.

Në lidhje me të gjeturat e të paditurit sa i përket pushimit të lehonisë së punonjësës të punësuar tek paditësi i parë, gjykata nuk gjeti të ketë çfarëdo ndërlydhje në mes të gjendjes faktike reale dhe pretendimeve të organit të paditur për shkelje të dispozitave ligjore sa i përket pushimit të lehonisë. Në këtë drejtim, gjykata në plotëni e gjithnjë duke i marrë parasysh provat materiale sa i përket pushimit të lehonisë për punonjësën në fjalë, i fali besimin e plotë paditësit të dytë dhe erdhi në përfundim se në kërkesën për pushimin e lehonisë ishte përcaktuar edhe periudha e pushimit të lehonisë dhe nuk ka qenë i nevojshëm nxjerrja e një vendimi të ri pasi që neni 67, paragrafi 6 nuk e kërkon një gjë të tillë.

Gjykata hodhi poshtë pretendimet e të paditurit se paditësit nuk kanë caktuar ekspert për sigurinë në punë duke kontestuar kështu angazhimin e një punëtori me shërbime të veçanta, duke u mjaftuar vetëm në deklarin se punëdhënësi nuk ka eliminuar parregullësitë e lartëcekura, e duke mos konstatuar saktë dhe drejtë afatet e dhëna dhe potencialisht të parespektuara nga ana e paditësve. Qasja e tillë e të paditurit është në kundërshtim me nenin 6 të LPPA-së, përkatësisht Parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit ku përcaktohet: “**Neni 6-Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit**

1. *Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.*

2. *Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse.*

3. *Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit*”. Poashtu, qasja e tillë bie në kundërshtim edhe me nenin 7 Parimi i objektivitetit dhe paanësisë ku përcaktohet: “**Neni 7-Parimi i objektivitetit dhe paanësisë**

1. *Organi publik duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme.*

2. *Veprimet e zyrtarit publik nuk duhet të ndikohen nga ndonjë interes personal, familjar, miqësor, politik apo nga presioni politik*”.

Gjykata mori në konsideratë të gjitha pretendimet tjera të të paditurit dhe për të njëjtat erdhi në përfundim se janë të paargumentuara, të paligjshme dhe të pambështetura në fakte apo në të drejtën materiale.

Vendimi në lidhje me shpenzimet procedurës u mor në bazë të nenit 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.468/17, datë: 12.05.2022

Gj y q t a r i

---

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.